FROSKA SAPUNXHIEVA FLURIM ZULFIJA
VESELINKA MAXHAROVA

ARSIMI MUZIKOR

PËR KLASËN VI

ARSIMI FILLORË NËNTËVJEÇAR

FROSKA SAPUNXHIEVA FLURIM ZULFIJA
VESELINKA MAXHAROVA

ARSIMI MUZIKOR

PËR KLASËN VI
ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



Autorë:
mr. Froska Sapunxhieva
mr. Flurim Zulfija
Veselinka Maxharova

Recensentë:
mr. Zana Dimçevska - kryetare
Zorica Vuçinoviq - anëtare
Zoran Grkovski - anëtar

Titulli i botimit origjinal:
Музичко Образование за VI Одделение деветогодишно основно образование

Botues:
Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Rr. "Shën Kirili dhe Metodi", nr. 54, 1000 Shkup

Përktheu nga gjuha maqedone:
Shpresa Ismaili

Lektor:
Mavie Mehmeti

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe:
Dardan Braimi

Radhitja kompjuterike:
Arbëria Design (Gavrilo Angeloski)

Përpunimi kompjuterik dhe dizajni grafik:
Veselinka Maxharova

Vendi dhe viti i botimit:
Shkup, 2022

Me vendimin e Komisionit Kombëtar për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 26-1107/1 të datës 09.07.2020, miratohet përdorimi i këtij libri shkollor.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

78(075.2)

SAPUNXHIEVA, Froska
Arsimi muzikor [Електронски извор] : për klasën VI : arsimi fillor nëntëvjeçar / Froska Sapunxhieva, Flurim Zulfija, Veselinka Maxharova ; përktheu nga gjuha maqedone: Shpresa Ismaili. - Текст во ПДФ формат, содржи 78 стр., илустр. - Shkup : Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):
https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Muzicko_6_albanski.pdf. - Превод на делото: Музичко образование за 6 одделение деветогодишно основно образование / Фроска Сапунџиева, Флурим Зулфија, Веселинка Маџарова. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 19.08.2022

ISBN 978-608-273-085-1

1. Zulfija, Flurim [автор] 2. Maxharova, Veselinka [автор]
а) Музичко образование -- Учебници, основно образование

COBISS.MK-ID 58000901

“Muzika në fushën e tingujve merret me të bukurën,
dhe vetëm njerëzit e mirë mund ta shijojnë të bukurën.“

Platoni



“Muzika është art e cila përmes tingujve
i shpreh ndjenjat“

Hajnrih Kristof Koh

ДЕНЕС НАД МАКЕДОНИЈА / SOT MBI MAQEDONINË

Teksti: Vlado Maleski
Muzika: Todor Skalovski



Одново сега знамето се вее,
на Крушевската република!
Гоце Делчев, Питу Гули,
Даме Груев, Сандански!
Гоце Делчев, Питу Гули,
Даме Груев, Сандански!

Горите Македонски шумно пеат,
нови песни, нови весници!
Македонија слободна,
слободно живее!
Македонија слободна,
слободно живее!

ELEMENTET E EDUKIMIT MUZIKOR
(Çelësi i violinës, pentagrami dhe nota)

DETYRA



- ✓ Cilat tone mungojnë në këtë tabelë?
- ✓ Në fletoren e notave të muzikës shkruani notat prej tabelës sipas radhitjes, sipas emrit dhe sipas vendit të shënuar.

ODA E GËZIMIT



"Oda e Gëzimit" (në gjermanisht "Ode an die Freude") është himni i Bashkimit Evropian. Në vitin 1971 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës vendosi ta propozojë "Odën e Gëzimit" nga "Simfonia e Nëntë" e Betovenit për t'u miratuar për Himnin Evropian. "Oda e Gëzimit" është si një ylber - me shkëlqim verbues dhe realisht - joreale, e paprekshme por aq e afërt".

Himni është një këngë solemne.

Oda e gëzimit

G'zim e lule bukurie,
Rreze elisioni.
Forca yte hieshie,
Të lart'son misioni.
Shteg mbi ura ënd'ra yte
triumfon ndaj ligësis'.
Shkrepe lart s'i rreze drite
Nën hije të urtësis'

G'zim ti je i mrekullushëm
jetën ton' çdo dit' stolis'.
N'pragun tënd o të magjishëm
buron kënga udhën nis.
Se atë që mbyt mërzia
ti sërish e gjallëron.
Vllazërohet njerëzia,
flatra jote ku pushon.

Neşeye Şarkı

Kardeş olun ey insanlar,
Bunu ister Tanrımız!
Bu dünyada herşey geçer,
En son sana dost kalır.

İnsanlığa doğruluğa,
Göğsünü aç korkma sakın.
Hür doğmuştur insanoğlu,
Hür yaşamak hakkıdır.

Ода радости

Радост краси све лепоте,
Кћери из Јелисеја!
Опојна ти моћ красоте,
Узвишена мисија.

Твоје снове вежу нити,
Што растави многа зла.
Сви ће људи браћа бити,
Крила твоја спајат' зна.

Ода на радоста

Радост бистра убост чиста,
ќерко од Елизија,
опивна си моќ што блиска,
занес и поезија.
Твојте сништа спокој шират,
злото што го скротува.
Сите луѓе да се смират,
звукот твој ги сплотува.

Среќни да сте милиони
јас ви праќам бакнеж врел.
Дружба, братство, љубов,
слога да ни мине живот цел.
Другар ти со другар биди,
гордост има секој жив.
Тој пак тоа што го нема,
нема живот, нема здив.

Në vitin 1824 Ludvig Van Betoven e shkroi simfoninë e tij të fundit, Simfoninë e nëntë.

Ludvig Van Betoven

Fidrih Shiler

Fridrih Shiler shkroi poezinë "Për gëzimin" ("An die Freude") në vitin 1785 si "Festimi i vëllazërisë njerëzore". Pas vdekjes së tij kënga u bë tekst për shfaqjen e korit "Simfonisë së nëntë" të Betovenit.

FJALËSHPEJTA

Fjalëshpejta maqedonase:
Учителот вика
дека вика
не се вика вика,
туку вика
дека вика
се вика вели.

Fjalëshpejta shqipe:
Elelija bebelija,
baca m'bleu gurabija
lumi baca që s'harroi,
dhe bombonat mi premtoi.

Fjalëshpejta boshnjake:
Četiri čavke na ćerpiču
čučeći cijuču.

Fjalëshpejta është lojë e fëmijëve me fjalë që duhet thënë tri herë një pas një duke përshpejtuar shqiptimin, në atë rast duhet kujdes që të mos bëhen gabime.
Me enigma të shpejta mund të ushtrojmë shqiptimin e saktë të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve, duke qenë të kujdesshëm në diksionin e qartë (shqiptim i qartë i çdo shkronje me marrjen e duhur të ajrit).

Fjalëshpejta vllehe:
Misur, misur
tu misur.

Fjalëshpejtë serbe:
Медо меди не да меда,
не да медо меди меда.

Fjalëshpejta rome:
Baro varo, tuke maro.
Sarinenge te ha maro.

Fjalëshpejta turke:
I bu takatukaları takatukacıya
takatukalatmaya götür
Takatukacı takatukaları
takatukalatmam derse
Takatukacıdan takatukaları
takatukalatmadan al da gel.

Bëhu kreativ!
Shkruaj një fjalëshpejtë të shkurtër.

NOTA DHE PUSHIMI KATËRSHE DHE TETËSHE NË PENTAGRAM

Nota katërshe



Nota katërshe zgjat një rrahje

Pushimi katërshe



Pushimi katërshe zgjat një goditje

Nota është shenjë muzikore me të cilën i shënojmë tonet.

Shenjat me të cilat i shënojmë ndërprerjet e përkohshme të toneve quhen **pushime.**

Nota tetëshe



Dy tetëshe mund të shënohen të ngjitura me një vijë horizontale.



PA - RA

Dy nota tetëshe taktohen në një goditje

Pushimi tetëshe

Shënohet nga vija e katërt në formë të numrit shtatë.



PA - RA

Ushtrimi numër 1



Ushtrimi numër 2



DETYRA

- ✓ Sa pushime katërshe ka në ushtrimin numër një ?
- ✓ Interpreto ushtrimin numër dy në instrument fëmijëror ritmik.

Ushtrimi numër 3



Ushtrimi numër 4





DETYRA

- ✓ Sa nota katërshe ka në ushtrimin numër tre ?
- ✓ Interpreto ushtrimin numër katër në instrument fëmijëror ritmik.

ЗА СИТЕ ДЕЦА / RËT TË GJITHË FËMIJËT (sipas dëgjimit)

Muzika: A.Xhambazov
Teksti: V.Pujovski



Сакам да е песна светот
тивок бран, изгрев ран.
Сакам да е песна една
да е цвет, овој свет.
Сакам песна да се ори
тивок сон, sвезден sвон.
Сакам песна што ќе збори
sвезден sвон.

Рефрен:
За сите деца, да биде сонце,
да биде љубов, нека биде сјај.
Да биде копнеж, да бидат sвезди,
да бидат пролет личен, цветен мај!

SHTATORI (sipas dëgjimit)

Muzika: A. Imeri



TEMPO

Shpejtësia me të cilën plotësohen kompozimet muzikore quhet tempo.

Ngadalë ← Tempo themelore → Shpejt

Tempo themelore → Mesatare

Për ta përcaktuar më saktë shpejtësinë tonë duke kënduar dhe luajtur duhet të përdorim një metronom.

Tempoja shkruhet mbi pentagramin pas çelësit të violinës.

Moderuar



Nikollaj Rimski Korsakov (1844 - 1908) është kompozitor dhe dirigjent rus. Rrjedh nga një familje aristokrate me një traditë të gjerë të ushtarëve dhe marinarëve.
Edhe në fëmijërinë e tij të hershme ai shfaq talentin për muzikën, kështu që në moshën gjashtë vjeçare fillon të mësojë piano.

Fluturimi i Brumbullit - Nikollaj Rimski Korsakov
Kompozimi muzikor është pjesë e operës "Përralla për mbretin Salltan."
Kjo pjesë muzikore shfaqet kur mjellma transformon djalin e mbretit Salltan në një brumbull. Atëherë ai do të mund të fluturojë larg ku ai dëshiron të vizitojë babain e tij, i cili nuk e di se është gjallë.
Ky kompozicion për shkak të popullaritetit të tij, përveç në interpretimin orkestral, mund të gjendet edhe në interpretimin e instrumenteve tjera.

DETYRA

- ✓ Rendit llojin e tempos të kompozicionit ?
- ✓ Përderisa e dëgjuat kompozimin çfarë ndjenja zgjoi te ju ?

Volfgang Amadeus Mocart (**1756-1791**) është kompozitor austriak.
Për shkak të talentit të tij të madh e quanin "fëmiju mrekulli". Në moshën pesë vjeçare ai luajti si pianist i rritur. Edhe pse jetoi një jetë të shkurtër, ka shkruar mbi 600 kompozime.

Marshi turk - Vofgang A. Mocart
Supozohet se Mozarti shkroi këtë vepër në moshën 27 vjeçare. "Marshi turk" është një nga meloditë më të popollarizuara të Mocart-it e cila sjell hare, gëzim energji dhe humor të mirë. Në atë kohë në Europë gjithçka që ishte turke ishte moderne si: pirja e kafesë turke, përdorimi i mëndafshit në veshmbathje, poashtu edhe në mënyrën e veshjes, mbajtja e turbanit etj. Inspirimin për të shkruar këtë kompozicion Mocarti e morri nga daulltarët jeniçer turk sipas të cilës e quajti "Marshi turk".

Tomaso Albinoni (1671-1751) është kompozitor italian. Ka shkruar opera, muzikë instrumentale, koncerte mirëpo veçanërisht theksohet vepra e ashtuquajtur Adaxho në g-mol.

Adaxho - Tomaso Albinoni
Shpesh kjo vepër quhet edhe "Adaxho Albinoni" ose vetëm "Adaxho në g-mol".
Kompozimi është pjesa e dytë e një kompozicioni më të madh dhe shumë shpesh shfaqet në aranzhmane të ndryshme dhe instrumente të ndryshme.

DETYRA
- ✓ Rendit llojin e tempos të kompozicionit
- ✓ Përderisa e dëgjuat kompozimin, çfarë ndjenja zgjoi te ju ?

DETYRA
- ✓ Bisedoni rreth dallimeve ndërmjet tri kompozicioneve.

NOTA E PLOTË DHE GJYSMË NOTA DHE PUSHIMI NË PENTAGRAM





Gjysmë notë



Gjysmë pushimi



Leximi ritmik i toneve në ushtrimin melodik, pa i kënduar notat sipas lartësisë, quhet PARLATO.

Ushtrimi numër 1



Ushtrimi numër 2



DETYRA

- ✓ Sa pushime të plota ka në ushtrimin numër një?
- ✓ Interpreto ushtrimin numër dy në instrumentet ritmike fëmijërore.

Ushtrimi numër 3

Ushtrimi numër 4

Ushtrimi numër 5



DETYRA

- ✓ Taktoje ushtrimin numër tre parlato, pastaj me melodi.
- ✓ Sa pushime gjysmë të plota janë në ushtrimin numër katër?
- ✓ Interpreto ushtrimin numër pesë në instrumentet ritmike fëmijërore.

NDARJA E KËNGËVE POPULLORE SIPAS PËRMBAJTJES

Folklori muzikor është pjesë përbërëse e krijimtarisë së folklorit të çdo kombi. Folklori muzikor përbëhet nga tri pjesë të rëndësishme që janë të lidhura mes vete: këngë popullore, valle popullore dhe vegla muzikore popullore.

Kënga popullore në të kaluarën është përcjellë brez pas brezi, sipas traditës gojore. Autorët e këngëve popullore nuk dihen, sepse këngët nuk janë shkruar, por janë transmetuar gojarisht



Këngët popullore mund të këndohen pa shoqërimin e instrumenteve popullore. Një numër më i madh i këngëve popullore shoqërohen me këngë popullore instrumente dhe valle.

Këngët popullore familjare këndojnë tema nga jeta e përditshme e njeriut, si: dashuria e prindërve për fëmijët e tyre, dashuria e motrës ndaj vëllaut, momente të bukura dhe të trishta të jetës familjare.

Садила Тимка босилок / Ka mbjellur Timka borzilok



Në këngët popullore të dashurisë këndohet: dashuria mes dy të rinjve, bukuria e një vajze apo e një djali, duke u martuar me ndërmjetësues, dallimet sociale midis të rinjve (vajzë e varfër - djalë i pasur dhe anasjelltas) dhe perceptimet patriarkale të prindërve.

Ој, зелено зеленило / Moj, e gjelbër e gjelbëruar



Ој, зелено зеленило,
што си толку овенато?

Дали те слана осланила?
Дали те роса оросила?

Нит ме слана осланила,
нит ме роса оросила.

Тук ме мајка армасала
за едно момче што не сакам.

NUMËRUESIT

Numëruesit paraqesin të folur ritmik, pra shqiptimi ritmik dhe solid i tekstit. Ju, fëmijët, por edhe prindërit tuaj kur ishin fëmijë i përdornin për të numëruar në lojërat e fëmijëve që kanë për detyrë në mënyrë të duhur për t'i caktuar rastësisht një detyrë dikujt (për shembull: të mbyll sytë, të kërkoj dikë ose një objekt, të ndiqet, të jet në mes, etj.)





Eni, meni, dudu meni, karanferi, mustaferi,
xhambaz-kokotaz, heshtje-heshtje, përallë! Ja ty kafshim!



Një, dy, tre-kam pulat e mija, Katër, pesë, gjashtë-kam këmishë të mirë
Shtatë, tetë, nëntë-kam dy palë këpuca. Dhjetë-numëroj gishtërinjtë e mi.



Pi, pi, pi, pi, pi, pi, pi, nënë kemi shumë uri.
Ko, ko, ko, ko, ko, ko, të marr një, të jap dy!



Shkoi Medo në shitore, nuk tha "mirëdita"
por tha "mirëmbrëma" u përkul dhe iku.



Mirëserdhe, mirëserdhe! Pse jeni me duar bosh
Kur jeni të ftuar, sjellni dhuratë!



Pis, pis, maca e vogël në dritare lëvizte dorën.
Atje është miu i vogël, pjatat që lëpinte



DINAMIKA

Dinamika është fuqia e zërit me të cilën këndojmë ose luajmë një kompozicion muzikor

Lehtë ← **Llojet themelore të dinamikës** → **Fuqishëm**

Ngjyrosja dinamike është një ndryshim gradual i volumit nga i qetë në zë më të lartë dhe anasjelltas, nga zhurma në heshtje. Në muzikë atë ndryshim mundet vetëm ta dëgjojmë por jo edha ta shohim. Në artet figurative ndryshimin gradual të një ngjyre mund ta shohim në nuanca të ndryshme si për shembull ngjyrën e kaltër.

1. BURIMET Një burim i vogël, i ngrohtë dhe i gëzuar, shkëlqen në hijen e pyllit. Dëgjohen valët e vogla të përfaqësuara nga tingulli i fyellit. Nga ana tjetër vjen një burim i ftohtë dhe i errët që kap me zë klarinetën. Duke depërtuar nëpër pyll, të dy burimet bashkohen.



2. LUMI U krijua lumi Vltava. Rrjedh pranë livadheve, pyjeve, maleve dhe vendeve shkëmbore. Bëhet një lum i valëzuar dhe i fortë. Muzika, gjithashtu do t'ju bëj me dije se lumi po bëhet më i madh më i fortë dhe më i zëshëm.

Bedzih Smetana (1824 - 1884) është një kompozitor çek. Në veprat e tij shihen elementet e folklorit kombëtar.

VLTAVA - Bedzih Smetana

"Vltava" është një kompozim i shkruar për orkestër. Brenda saj kompozitori Bedzih Smetana përshkruan muzikalisht natyrën dhe traditën e vendit të tij. Poemën simfonike Vltava, e shkroi i frymëzuar nga ujërat e turbullta të lumit çek Vltava.

3. GJUETIA "Vltava" nxiton nëpër pyll nëpër të cilin lëvizin gjuetarët e drerit dhe befas dëgjohet instrumenti korna e shoqëruar nga daullja dhe një orkestër që lajmëron fillimin e gjuetisë. Ritmi të kujton një marshim ushtarak dhe ju mund të ndjeni erën që fryn në fytyrën tuaj përderisa kalëroni.

4. DASMA Lumi gradualisht po i afrohet fshatit ku bëhet dasma. Në livadhin e gjelbër dhe të lulëzuar dëgjohet një muzikë e hareshme. Në rrjedhje është zhvillimi i dasmës. Të ftuarit të lumtur vallzojnë në ritmin e Polonisë (Valle popullore Çeke e cila vallëzohet në çifte).

5. ZANAT Natën buzë lumit dalin rusalët (zanat e ujit) dalin nga uji i qetë dhe vallëzojnë nën dritën e hënës. Dëgjohet muzikë e qetë si ninullë e interpretuar në instrumentin e violinës. Mbyllni sytë dhe imagjinoni një fotografi të zanave të bukura me flokë të bardha, të veshura në të bardha, që kërcejnë në brigjet e hënës.



7. PRAGA Lumi është i madh dhe rrjedh nga qyteti i Pragës, poashtu kalon edhe pranë kështjellës Vishegrad. Dëgjohet një tingull solemn nga truba dhe cimbalat. Lumi është i madh i gjërë dhe gradualisht humbet në largësi.

6. UJËVARA Po vjen lumi në një peizazh malor shkëmbor.
Valët goditin shkëmbinjtë dhe krijohen rrjedhë e shpejtë dhe ujëvara. Uji trazohet, bëhet gjithçka më i shqetësuar, më i madh dhe më i shpejtë. Fortësia e melodisë kap tingullin e fuqishëm të ujëvarës.

DETYRA

Në fletoren e notave muzikore bëni një përshkrim grafik dhe në secilën grafë shkruani emrin e fotografisë me zë:

1.Burimet 2.Lumi 3.Gjueti 4.Dasma 5. Zanat 6. Ujëvara 7. Pragë.

Në secilën grafë shkruani dinamikën dhe tempon e seksionit.

VËLLA I DASHUR / БАТЕ СИМЕ (sipas dëgjimit)



Vëlla i dashur

Vëlla i dashur, vëlla i dashur
A po flen, a po flen?
Këmbanat po bien,
këmbanat po bien.
ding dang dong,
ding dang dong.

Бате Симе

Бате Симе, бате Симе,
спиеш ли, спиеш ли?
Сите ѕвона ѕвонат,
сите ѕвона ѕвонат,
бим-бам-бом, бим-бам-бом.

Haydi Serdar

Haydi Serdar, haydi Serdar
Gün doğdu, gün doğdu
Saat sekiz oldu, saat sekiz oldu
Ding dang dong,
ding dang dong.

Драги Бато

Драги Бато, драги Бато
спаваш ли?
Спаваш ли?
Већ звоне сва звона,
Већ звоне сва звона,
Динг, донг, данг,
динг, донг, данг.

ТАТКОВИНО / ATDHEU (sipas dëgjimit)

Muzika dhe teksti
Veselinka Maxharova



Колку убава е
мојата татковина.
Со езера, реки, планини
и плодни полиња.

Рефрен:
Татковино моја мила,
од срце те љубам јас.
Вечно сонце нека грее
над твојата убавина.

Во нас спомен е драг,
за храбри јунаци.
За минато славно големо,
на најмил народ свој.

Рефрен:
Татковино моја мила,

TAKTE TË THJESHTA 2/4, 3/4 DHE 4/4

Për lexim dhe përcjellje më të lehtë të tekstit muzikor, pentagrami ndahet në pjesë më të vogla të quajtura takte.



Distanca nga njëra vijë në tjetrën vijë të masës quhet (masa kohore) takti.

Para dhe pas secilit takt ka një vijë vertikale në pentagram. Ajo vijë quhet **vija e taktit** dhe i ndanë taktet njëra prej tjetrës.

Fundi i këngëve dhe kompozimeve shënohet me vijë takti të dyfishtë (njëra më e hollë dhe tjetra më e trashë) e quajtur **vija fundore ose finale e taktit.**

Të mësojmë çka nënkuptojnë numrat që i shohim te çelësi sol. Ato quhen **matje e taktit.**

Numri lart shënon pjesët e taktit (**me sa kohë takti**) do të numërojmë në secilin takt.



Numri poshtë na tregon cila vlerë e notës shërben si pjesë e taktit ose (**me çfarë kohëzgjatje të taktit**) duhet të numërojmë.

Takti dypjesor





Takti trepjesor



Takti katër pjesor





Bëhu kreativ!
Në fletoren e notave muzikore shkruani një ushtrim ritmik sipas zgjedhjes tuaj në kohë 2/4, 3/4 ose 4/4 prej katër taktesh.

KËNGË POPULLORE HUMORISTIKE DHE TË PUNËS

Këngët popullore humoristike janë këngë të gëzueshme dhe të hareshme. Në të këndohen mangësitë e njerëzve si: përtacia, marrëzia, po ashtu ka edhe këngë ku kafshëve u japin tipare njerëzore.

Бог да биде петлето / Zot qoftë gjeli



Бог да бие петлето,
што ми рано пропеа.
Па будеше бабата
да замеси зелникот.

Нешто крекна в зелникот.
Нешто мрдна в зелникот.
Сите викат жаба е,
баба вика мечка е.

Дур го баба замеси,
товар брашно измеси.
Дур го баба насоли,
каца пресол истури.

Сите зеа вилите,
баба зеде грабула.
Да претресе зелникот,
да ја најде мечката.

Дур го баба испече,
товар дрва изгоре.
Испече се зелникот,
па седнале да јадат.

Сите бегат низ врата,
баба бега низ баца.
Сите идат со круши,
баба иде без уши.

Këngët popullore të punës janë të lidhura me obligimet e përditshme që ka pasur populli jonë për të ushqyer familjen. Këngë të tilla janë si: të çobanëve, të kurbetit, të korrave dhe punëtorëve.

Распукала Шар Планина / Plasi Mali Sharr



Ani mori nuse



II

As s'po due rruze,
as s'po due pare.
Por e dua burrin,
pasha me cigare.

III

Ani me cigare,
ani me kuti-e
E me këpucë t'zeza
veshun si zotnie

Dzelem, dzelem



Ala voliv lake kale jakha,
kaj si gugle sar duj kale drakha.
Ala voliv lake kale jakha,
kaj si gugle sar duj kale drakha.

Refren: Oooh, Romale!
Oooh, chavrale

Kindem lake lolo dikhlo tursko,
ni volil man achel latar pusto.
K indem lake lolo dikhlo tursko,
ni volil man achel latar pusto.

Refrem: Oooh, Romale!

Motivi është pjesa
më e imët muzikore.
Motivi është pjesa më e vogël e këngës
ose një kompozimi muzikor.



motiv motiv motiv motiv

fraza

Dy motive bëjnë
një frazë

fraza

Кап, кап, кап

Fraza është tërësia më e vogël formale metrike.
Fraza është tërësi muzikore (pjesë më e madhe se motivi) më shpesh përmban dy motive.

ситен дождец
роси

Në këngët dhe kompozimet muzikore do të takoni shumë fraza, por për gjysmë më pak se motivet.

КАП, КАП, КАП / PIKA, PIKA, PIKA (KËNDIM DHE MUZIKË)



DETYRA

- ✓ Gjeni motivet dhe frazat te kënga me lexim të tekstit.
- ✓ Ndahuni në dy grupe dhe aplikoni lexim dinamik dhe këngë te motivet dhe frazat e këngës, për shembull:një motiv grupi i parë e këndon qetë, dhe motivin e dytë grupi tjetër e këndon me zë më të lartë dhe anasjelltas.
- ✓ Këndoni dhe luani motivet dhe frazat në mënyrë jo të njëjtë të këngës.

MUZIKA VOKALE

Tingujt e njerëzve ndahen në: të burrave, grave dhe fëmijëve.

Muzika e cila **interpretohet** vetëm me tinguj të njerëzve pa shoqërimin e ndonjë instrumenti quhet **MUZIKË VOKALE.**

Në muzikë nën emrin **kompozim** nënkuptohet forma muzikore (forma) që ka një kohëzgjatje të caktuar fillim dhe fund.

Solist është një interpretues muzikor që këndon vetëm, para korit ose në shoqërimin e ndonjë instrumenti muzikorë ose orkestër.

Kori është një ansambël vokal i shoqëruar nga një grup më i madh i këngëtarëve që plotësojnë kompozime të shumta më zë me ose pa shoqërimin e ndonjë instrumenti.

HISTORI MUZIKORE - Voca People

Njerëzit nga Voca people tregojnë aventurë muzikore emocionuese dhe origjinale gjatë historisë. Këta janë tetë, këngëtarë të mrekullueshëm, të talentuar-humoristë, plot energji dhe argëtim që nuk përdorin instrumente muzikore por performojnë efektet e zërit të prodhuara ekskluzivisht përmes këngës së tyre drejtpërdrejtë, duke kombinuar teknikat moderne. Ky grup vokal ka ripunuar më shumë se 80 hite nga artistë të famshëm të muzikës argëtuese si Madonna dhe Michael Jackson, por edhe ribërje të muzikës klasike.

NA ISHIN DY KUNATA - R. Rudi

Kompozimi i famshëm "Na ishin dy kunata" është shkruar për kor të përzier. Flitet për dy kunata që shkojnë mirë dhe duhen si motra. Autori është inspiruar nga folklori i popullit shqiptar.
Rafet Rudi lindi më 5 Janar të vitit 1949 në Mitrovicë. Shkollën e mesme të muzikës e mbaroi në Prishtinë, kurse diplomoi dirigjimin në Akademinë e Muzikës në Beograd. Është profesorë i rregullt në Akademinë e Muzikës në Prishtinë.Që nga viti 1999 është drejtues dhe themelues i Remuzika / Nova muzikë. Që nga viti 2006 është dirigjent i Korit të Filharmonisë të Kosovës, dhe veprat e tij janë interpretuar në mbarë botën. Rafet Rudi kompozoi disa lloje kompozimesh muzikore: vokale dhe vepra instrumentale, muzikë për teatër dhe film, e më shumë.

RUM, DUM, DUM - Dragan Shuplevski

"Rum, dum, dum" është një kompozim nga koleksioni i aranzhimeve të korit të këngëve popullore maqedonase Verë e kuqe dafine, e bërë një nga dirigjentët më të njohur të korit maqedonas, Dragan Shuplevski. Në vepër është thurur dhe ruajtur në mënyrë mjaft interesante folklori i popullit maqedonas. Kjo vepër është realizuar nga shumë kore në botë. Dragan Shuplevski (1933 - 2001) është dirigjent kori, kompozitor dhe pedagog. Themelues i më shumë koreve profesionale dhe amatore të Maqedonisë: kori akademik Mirçe Acev, kori i radios i Radio-Televizioni Shkup, kori i fëmijëve Razvigorce, kori i të rinjve në Qendrën Rinore dhe të tjerë. Emrin e tij sot e mban kori pranë Fakultetit të artit muzikor në Shkup.

DETYRA

- ✓ Çfarë lloji të shfaqes muzikore dëgjuat në kompozimet (vokale apo instrumentale)?
- ✓ Në çfarë tempo janë shfaqur kompozimet?
- ✓ Bisedoni rreth dallimeve ndërmjet tri kompozimeve.

ПРОЛЕТ / PRANVERA (sipas notave)

Muzika dhe teksti:
Froska Sapunxhieva



MOLLËZO (me dëgjim)

Muzika: S.Qefa



1.Mollëzo, mollëzo
faqe kuqe vogëlo.
Pse qëndron përpjetë
fshehur nëpër fletë.

2.Mollëzo, mollëzo
fshihesh kot, por un' të shoh
eja pa vonuar
hidhmu fup në duar.

refreni:Thot molla çupëzo
faqe kuqe vogëlo
ngjitu në je trime
gjer në degën time.



SHKALLA C-dur

Shkalla C-dur emrin e ka marrë pas tonit fillestar C, për atë quhet shkalla C-dur.

C-dur



I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
C	D	E	F	G	A	H	C

Vendi i tingujve në shkallën muzikore quhet **GRADË.**
Grada shënohen me numra romak.

C-dur



I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
C	D	E	F	G	A	H	C

Distanca ndërmjet dy gradëve (tone fqinje) quhet TON.

Dallojmë dy lloje të toneve:
TONI I PLOTË ⌣ GJYSMËTONI ∧.
Tonet e plota në shkallën C-dur hasen ndërmjet:
gradëve I-II; II-III; IV-V; V-VI dhe VI-VII .
Gjysmë shkallë në C-dur haset ndërmjet gradës III-IV dhe VII-VIII.

C-dur



C-dur



Nëse e ndajmë shkallën C-dur në dy pjesë të barabarta C D E F dhe G A H C2, do të vërejmë se renditja e toneve të plota dhe e gjysmëtonëve është e njëjtë në të dyja pjesët. Këto pjesë të shkallës quhen TETRAKORDE (nga fjalët greke tetra-katër dhe korda-tel)
C D E F quhet tetrakorda e poshtme ose e parë, a
G A H C2 quhet tetrakordi i sipërme ose i dytë.



До ре ми фа сол ла си до це дур јас ја на - у - чив.



Се - га знам за ста - па - ло, те - тра-корд и сте - пен.

DETYRË

Me zgjedhjen e saktë të anagramit kërmill dhe të rebuseve, do t'i fitoni elementet muzikore nga e cila është ndërtuar shkalla C-dur. (përgjigjet i shënoni në fletoren e notave muzikore).

Anagrami kërmill



Rebus



Rebus



MUZIKA INSTRUMENTALE

Muzika e cila ekzekutohet vetëm me instrumente muzikore quhet **MUZIKË INSTRUMENTALE**

Instrumenti muzikor është mjet në të cilën luhet në një mënyrë të caktuar me teknikë adekuate.



Nën termin **ansambël** (**orkestër**) nënkuptojmë një grup më i madh i njerëzve që luajnë në instrumente muzikore dhe bashkë realizojnë një kompozim muzikor.

Dirigjenti është një muzikant që drejton orkestrën/korin gjatë provave dhe koncerteve. Dirigjenti është përgjegjës për performancën e plotë të një pjese muzikore.
Ai, me lëvizjen e duhur të duarve (përcjelljen), u jep shenja interpretuesve për: fillimin dhe mbarimin i njësive muzikore dhe kompozicionin, ritmin, dinamikën dhe elementet tjera muzikore shprehëse.

BADINERA - J. S. Bah

"Badinera" është një lojë franceze që ishte e njohur në shekullin XVII dhe shekullin XVIII. "Badinera" është një pjesë integrale e suitës, një vepër orkestrale e përbërë nga një sërë lojërash të njohura në kohën e Johan Sebastian Bah.
Instrumenti që bie në sy quhet flauta dhe bën pjesë në grupin e instrumenteve frymore. Johan Sebastian Bah (1685-1750) është një nga kompozitorët më të rëndësishëm gjerman. Bah kishte shumë fëmijë dhe donte që të gjithë fëmijët e tij të arsimoheshin në muzikë dhe të mësonin të luanin piano. Ai shkroi shumë kompozime për piano-nga më të lehtat, për fillestarët, deri te kompozimet për performancën e koncertit. Bah njihej edhe si orgulist. Veprimtaria e Bahit është e gjerë dhe e larmishme.

HUMORESKA - A. Dvorzhak

Termi "humoreska" është një shaka.
Nën emrin "humoreska" Dvorzhak shkroi një cikël prej tetë pjesësh piano. Pjesa e shtatë, e quajtur "Humoreska", arriti popullaritetin më të madh-që sot interpretohet në mënyrë të pavarur në instrumente të ndryshme. Instrumenti që bie në sy quhet violinë dhe i përket grupit të instrumenteve me tela. Antonin Dvorzhak (1841-1904) ishte kompozitor dhe violinist çek. Karakteristikë për veprat e tij është se në to përdor me sukses folklorin çek, por edhe folklorin muzikor të popujve të tjerë.

"SONATA FAÇILE" - V. A. Mocart

"Sonata Façile" është një kompozim piano "për fillestarët." Të njëjtin kompozim mund ta gjejmë nën dy emra "Sonata facile" dhe "Sonata semplice" ose në përkthim "Sonata e lehtë" dhe "Sonata e thjeshtë". Të dy emrat sugjerojnë se është një kompozim muzikor i synuar për fillestarët për shkak të thjeshtësisë së tij.

Anekdotë

Kur djali trembëdhjetë vjeçar i shokut të tij pyeti se si të kompozonte, Mocarti u përgjigj: "Asgjë, asgjë nga këto, ju duhet të prisni akoma.
– "Por ju jeni maestro, e keni nisur shumë më herët ju të kompozoni", kundërshtoi fëmiu, pak i ofenduar.
- "Po, por nuk kam pyetur asnjëherë se si është bërë!", u përgjigj Mocarti, duke qeshur me dashamirësi.

DETYRA

- ✓ Cilës performancë muzikore i përkasin kompozimet (vokale ose instrumentale)?
- ✓ Përcaktoni ritmin dhe dinamikën e kompozimeve.

Në fletoren e notave muzikore shkruani ndryshimet dhe ngjashmëritë midis kompozimeve.

NOTA si (h) E VOGËL

Mënyra e shënimit të tonit si (h) e vogël.

Nota si (h) e vogël shënohet nën vijën e parë ndihmëse të pentagramit.





Tingujt si (h) e vogël dhe si (h1) kanë emrin e njëjtë, por dallohen sipas lartësisë dhe vendndodhjes në pentagram.

Ushtrimi nr. 1



Ushtrimi nr. 2



DETYRA

- ✓ Përshkruani ushtrimin nr 1 dhe 2
- ✓ Numëroni se sa herë nota si (h) e vogël shihet te Ushtrimi nr 1 dhe sa herë te Ushtrimi nr 2

Pčela



Okulumuz

Muzika: Habibe Kubur
Teksti: Rakim Çallapalla



Her yerden daha güzel
bizim için burası.
Okul sevgili okul
neşe bilgi yuvası.

Senin çatın altında
girmez kötü duygular.
Bilgi giren yerlerde
kalmaz artık kaygılar.

Güzel kitaplar burada
birçok arkadaş burada.
Insan nasıl sevinmez
böyle yerde okur da.

Her yerden daha güzel
bizim için burası.
Okul sevgili okul
neşe bilgi yuvası.

NOTA la (a) E VOGËL



Nota la (a) e vogël shënohet në vijën e dytë ndihmëse nën pentagram.



Mënyra e shënimit të tonit la (a)



la (a)
e vogël

